REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

V E N D I M

Nr. 02, datë 17. 01. 2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
"PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integrimit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve jobanka", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 25, datë 24.03.2010.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SEKRETARI	**KRYETARI**
YLLI MEMISHA	**ARDIAN FULLANI**

RREGULLORE

"PËR ADMINISTRIMIN E RREZIKUT NË VEPRIMTARINË E SUBJEKTEVE FINANCIARE JOBANKA"

(Miratuar me vendimin nr. 02, datë 17.01.2013 dhe ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 06.09.2017, me vendimin nr. 50, datë 3.7.2019, me vendimin qarkullues nr. 14, datë 12.3.2020 dhe me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë)

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka.

Neni 2
Baza juridike

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 1, pika 4, shkronja "b", dhe të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
b) nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i cili më poshtë në këtë rregullore do të quhet "ligji për bankat".

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë [1] subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë, të licencuar për të ushtruar veprimtari financiare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin për bankat dhe në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka".

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime:

   a) [2] **"kapital rregullator" –** është kapitali që përdoret për matjen e treguesve rregullatorë dhe llogaritet si shuma algjebrike e elementeve të mëposhtme të bilancit:

[1] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

i. kapital i paguar,
ii. primet e aksioneve,
iii. rezervat,
iv. diferenca rivlerësimi,
v. fitimet e pashpërndara,
vi. fitim-humbja e vitit ushtrimor,
vii. (minus) pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve të tjera,
viii. borxhi i varur.

b) **"kredi me probleme"** – është totali i kredisë (kryegjë dhe interes) të klasifikuar në tre kategoritë e fundit, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje;

c) **"kredi me probleme neto"** – është totali i kredisë me probleme (kryegjë dhe interes), duke zbritur fondin rezervë të krijuar për mbulimin e humbjeve nga këto kredi;

d) [3]**shfuqizuar;**

e) **"ristrukturimi i kredisë"** – është lehtësimi/et që subjekti bën për kredimarrësin/it për shkak të vështirësive financiare të tyre, të shkaktuara nga arsye ekonomike ose ligjore, të cilat nuk bëhen nga subjekti në asnjë rast tjetër, dhe përfshijnë në përgjithësi:

i. lehtësimet e bëra në kushtet e kredisë, nëpërmjet ndryshimit të një ose disa kushteve të kontratës (duke përfshirë ndryshimin e produktit dhe kapitalizimin e interesit), të cilat lidhen kryesisht me afatin, kryegjënë dhe normën e interesit,
ii. marrjen (përdorimin) e kolateralit apo pasurive të tjera për shlyerjen e pjesshme të kredisë,
iii. zëvendësimin e kredimarrësit fillestar ose përfshirjen e një ose më shumë kredimarrësi shtesë.

f) [4]**"borxhi i varur"** – është instrument kapitali, kontrata e të cilit në rast se parashikon një datë të caktuar për shlyerje, periudha fillestare e maturimit duhet të jetë jo më e vogël se 5 vjet, ose në rast se nuk parashikon një datë të caktuar, detyrimi mund të shlyhet me një njoftim paraprak prej 5 vjetësh, si dhe në asnjë rast nuk parashikohet shlyerja para afatit, pa miratimin e Bankës së Shqipërisë. Shlyerjet nuk përdoren për mbulimin e humbjeve.

[5]Subjektet përfshijnë borxhin e varur në kapitalin rregullator, deri në 50% të shumës së elementeve të kapitalit deri më 31.12.2023 dhe, duke filluar nga 1.1.2024, deri në 33.3 % të shumës së elementeve të kapitalit, vetëm nëse plotësohen kërkesat e përcaktuara në shkronjën "f" të pikës 2 të këtij neni. Për qëllime të kësaj llogaritjeje, konsiderohet shuma e elementeve të kapitalit të parashikuara në nënpikat "i" deri në "vii" të shkronjës "a" të pikës 2 të këtij neni.

Subjekti që kërkon të përfshijë borxhin e varur në kapitalin e tij rregullator[6], njofton Bankën e Shqipërisë, dhe paraqet dokumentacionin e mëposhtëm:

---

[2] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[3] Shfuqizuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[4] Shtuar me vendimin nr.46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[5] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[6] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

i. kontratën e lidhur për emetimin e borxhit të varur;
ii. një ilustrim skematik të plotësimit [7]të kërkesave dhe karakteristikave të borxhit të varur të përcaktuara në shkronjën "f" të pikës 2 të këtij neni, duke dhënë referencat përkatëse në kontratë;
iii. një përshkrim të trajtimeve kontabël të borxhit të varur, së bashku me një opinion nga një auditues ligjor ose shoqëri auditimi, në lidhje me pranueshmërinë e tij; si dhe
iv. një deklaratë mbi burimin e ligjshëm të fondeve të huazuara.

KREU II
ADMINISTRIMI I RREZIQEVE PËR TË GJITHA SUBJEKTET

NËNKREU I
PARIMET DHE RREGULLAT BAZË TË DREJTIMIT TË PËRGJEGJSHËM DHE EFEKTIV

Neni 5
Organet drejtuese dhe kultura e përgjithshme e drejtimit

1. Organet drejtuese, në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësive që lidhen me drejtimin dhe kontrollin e subjektit, njohin në mënyrë të plotë dhe të qartë profilin e rrezikut të subjektit, duke përcaktuar/miratuar paraprakisht ndërmarrjen dhe tolerancën ndaj tij (rrezikut), si dhe ndjekjen në vazhdimësi të tij në përputhshmëri me këto të fundit, duke siguruar që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm këtë rrezik.

2. Organet drejtuese, nëpërmjet mënyrës së drejtimit, nxisin (stimulojnë) një kulturë të përshtatshme drejtimi, e cila ka si përparësi ndershmërinë dhe krijimin e marrëdhënieve korrekte ndërmjet nëpunësve, të bazuar në standarde të larta profesionale dhe vlera të larta etike.

3. Organet drejtuese marrin masa për arritjen e standardeve të larta etike dhe profesionale në drejtimin e subjektit.

Neni 6
Sistemi i administrimit të rrezikut

1. Subjektet krijojnë dhe zhvillojnë sistemin për administrimin e rrezikut, të përshtatshëm me natyrën, vëllimin dhe kompleksitetin e veprimtarisë së tyre.

2. Sistemi i administrimit të rrezikut është tërësia e politikave, procedurave, rregullave dhe strukturave të subjekteve, që shërbejnë për administrimin e rrezikut.

3. [8]Sistemi i administrimit të rrezikut përfshin:

   a) procesin e identifikimit, të matjes, të monitorimit, të kontrollit dhe të raportimit, të të gjitha rreziqeve brenda një subjekti, në të gjithë aktivitetin e tij (për të gjithë bilancin, portofolin dhe linjat e biznesit);

[7] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[8] Shtuar me vendimin nr.50, datë 3.7.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

b) përcaktimin e funksioneve të strukturave të administrimit të rrezikut, të cilat sigurojnë:

   i. identifikimin e të gjitha rreziqeve;
   ii. vlerësimin e rreziqeve dhe matjen e ekspozimit ndaj tyre;
   iii. monitorimin e ekspozimit të rrezikut dhe përcaktimin e nevojave për kapital në mënyrë të vazhdueshme;
   iv. monitorimin dhe vlerësimin e vendimeve për pranimin e rreziqeve të caktuara, masat për zbutjen e rrezikut dhe nëse vendimet janë në përputhje me vendimet e organeve drejtuese për politikat e rrezikut;
   v. raportimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur, në organet drejtuese, të të gjitha çështjeve të përcaktuara më lart.

[9]Neni 6/1
Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm

1. Subjektet krijojnë funksionin/njësinë e kontrollit të brendshëm, si pjesë të sistemit të kontrollit të brendshëm.

2. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm është njësi organizative e veçantë e subjektit, e pavarur nga veprimtaritë, strukturat dhe personat që ajo shqyrton ose kontrollon, e cila raporton përpara këshillit të administrimit/mbikëqyrës dhe/ose komitetit të kontrollit të subjektit.

3. Çdo veprimtari, çdo departament, çdo degë dhe çdo njësi tjetër organizative e subjektit, përfshihet në fushën e kontrollit të funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm.

4. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm siguron, në mënyrë të pavarur, organet drejtuese mbi cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit, si dhe mbi sistemin dhe proceset e drejtimit/qeverisjes dhe të administrimit të rreziqeve.

5. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm zbaton standardet ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm.

6. Subjektet hartojnë dhe miratojnë akte të brendshme për funksionimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së këtij funksioni/kësaj njësie, të cilat hartohen dhe rishikohen sa herë gjykohet e nevojshme.

7. Aktet e brendshme që përcaktojnë mënyrën e funksionimit dhe të ushtrimit të veprimtarisë së funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm, përmbajnë minimalisht elementet e mëposhtme:

   a) qëllimin dhe fushën e veprimit të funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm;
   b) rolin, autoritetin dhe përgjegjësitë e funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm;
   c) marrëdhëniet e funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm me funksione të tjera të sistemit të kontrollit brenda subjektit;
   d) mënyrat dhe linjat e komunikimit të rezultateve të veprimtarisë së kontrollit;
   e) procedurat për koordinimin me audituesin ligjor ose shoqërinë e auditimit, si dhe me autoritetin mbikëqyrës;

[9] Shtuar me vendimin nr.50, datë 3.7.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

f) të drejtën për të përdorur në mënyrë të plotë dhe të pakushtëzuar çdo regjistrim, dosje, bazë të dhënash, aktive fizike të subjektit, si edhe çdo dokumentacion të organeve drejtuese apo njësive organizative, të nevojshme për kryerjen e funksioneve të këtij funksioni/kësaj njësie;
g) të drejtën e drejtuesit të funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm për të pasur kontakt të drejtpërdrejtë me organet drejtuese;
h) të drejtën e planifikimit dhe përcaktimit të kontrolleve në mënyrë të pavarur;
i) sigurimin e shmangies së çdo konflikti interesash në kryerjen e detyrave të kontrollit të brendshëm;
j) kërkesa për përputhshmërinë me standardet më të mira të kontrollit të brendshëm.

8. Frekuenca e kontrollit bazohet në vlerësimin e çdo fushe veprimtarie dhe/ose njësie organizative të subjektit të bazuar në rrezik. Të gjitha fushat e veprimtarisë dhe/ose njësitë organizative të subjektit janë objekt kontrolli nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm, të paktën çdo tre vjet, përfshirë edhe ato me rrezik të ulët.

9. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm përgatit një raport për çdo kontroll të kryer, i cili përmban të paktën:

   a) objektin e kontrollit;
   b) përshkrimin e punës së kontrollit (përshkrimin e metodologjisë, hapat dhe procedurat e ndjekura për të arritur objektivat e kontrollit etj.);
   c) gjetjet e kontrollit;
   d) komentet e drejtuesve përgjegjës të njësisë organizative të kontrolluar, për gjetjet e kontrollit;
   e) vlerësime për kualifikimin e personelit, mjaftueshmërinë e akteve të brendshme dhe sistemet e vlerësimit të rrezikut, sipas rasteve përkatëse;
   f) rekomandime për korrigjimin dhe përmirësimet e gjetjeve, të vërejtura gjatë aktit të kontrollit; si dhe
   g) nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga kontrollet e mëparshme.

10. Punonjësit e funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm kanë:

   a) reputacion të lartë etik dhe profesional;
   b) aftësi profesionale në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të kontrollit të brendshëm, të procedurave dhe teknikave të kontrollit në të gjitha fushat e aktivitetit të subjektit;
   c) njohje dhe/ose përvojë në zbatimin e standardeve të kontabilitetit;
   d) njohje të parimeve të administrimit të rrezikut.

11. Në fund të çdo viti, funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm përgatit planin e punës për vitin e ardhshëm, i cili paraqitet për miratim në organet drejtuese të subjektit.

12. Funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm paraqet një raport vjetor mbi punën e tij/saj tek organet drejtuese të subjektit, i cili përmban elementet e mëposhtme:

   a) një raport mbi nivelin e zbatimit të planit vjetor të punës së funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm;
   b) një listë të të gjithë aktiviteteve të planifikuara dhe të realizuara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm;
   c) një listë të të gjithë aktiviteteve të realizuara, por të paplanifikuara në planin vjetor të punës së funksionit/njësisë së kontrollit të brendshëm;

d) një listë të të gjithë aktiviteteve të planifikuara, por të parealizuara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm, shoqëruar me arsyet e mosrealizimit;
e) një përmbledhje të gjetjeve më të rëndësishme të identifikuara gjatë kontrolleve;
f) një vlerësim të përgjithshëm të mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të kontrollit të brendshëm, në fushat e mbuluara nga funksioni/njësia e kontrollit të brendshëm;
g) një vlerësim të përgjithshëm të mjaftueshmërisë dhe eficiencës së sistemit të administrimit të rrezikut;
h) një raport mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe masave korrektuese të përcaktuara në bazë të rekomandimeve, si dhe arsyet e moszbatimit të tyre.

[10]Neni 6/2
Funksioni i përputhshmërisë

1. Subjektet duhet të kenë një drejtues ekzekutiv, që kryen funksionin e identifikimit, koordinimit dhe të administrimit të rrezikut të përputhshmërisë.

2. Struktura/njësia e përputhshmërisë është e pavarur nga linjat e biznesit dhe nga njësitë e brendshme që kontrollon dhe ka autoritetin, reputacionin dhe burimet e mjaftueshme.

3. Përgjegjësia kryesore e strukturës/njësisë, që përmbush funksionin e përputhshmërisë së subjektit është të asistojë/ndihmojë organet drejtuese të subjektit, në administrimin efektiv të rrezikut të përputhshmërisë.

4. Struktura/njësia e përputhshmërisë këshillon organet drejtuese të subjektit, lidhur me përputhshmërinë me ligjet, rregullat dhe standardet, duke i informuar ato në vazhdimësi, mbi zhvillimet në këtë fushë, si dhe në veçanti kryen/përmbush detyrat e mëposhtme:

   a) edukimin dhe trajnimin e personelit për çështjet e përputhshmërisë, duke shërbyer dhe si pikë kontakti brenda subjektit për çështje apo pyetje të personelit lidhur me përputhshmërinë;
   b) hartimin e udhëzimeve të brendshme për zbatimin e ligjeve, të rregulloreve dhe të standardeve nëpërmjet politikave dhe procedurave apo dokumenteve të tjera, si manualet e përputhshmërisë, kodet e brendshme të etikës dhe udhëzimet praktike;
   c) identifikimin, dokumentimin dhe vlerësimin e rreziqeve të përputhshmërisë në veprimtarinë e subjektit, duke përfshirë produktet dhe praktikat e reja, tipet e linjave të reja të propozuara të veprimtarisë ose të marrëdhënieve me klientët dhe ndryshimet e rëndësishme në këto marrëdhënie;
   d) vlerësimin e ndikimit të mundshëm të çdo ndryshimi ligjor dhe rregullativ në veprimtarinë e subjektit dhe në kuadrin e përputhshmërisë;
   e) matjen e rrezikut të përputhshmërisë duke përdorur treguesit e performancës (të tillë si rritja e numrit të ankesave të klientëve, parregullsitë në pagesa etj.), me qëllim vlerësimin e këtij rreziku;
   f) vlerësimin e përshtatshmërisë së procedurave dhe rregulloreve të përputhshmërisë, si dhe vlerësimin e mangësive të identifikuara, duke mundësuar edhe propozime për amendime;

[10] Shtuar me vendimin nr.50, datë 3.7.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

g) monitorimin, testimin dhe raportimin e rezultateve nga testimi i mjaftueshmërisë së përputhshmërisë, sipas procedurave të sistemit të brendshëm të administrimit të rrezikut, duke evidentuar edhe ndryshimet në profilin e rrezikut të përputhshmërisë, mbështetur në treguesit e performancës, shkeljeve dhe/ose mangësive të identifikuara dhe të masave korrigjuese të ndërmarra;

h) krijimin e një kulture inkurajuese dhe të përshtatshme për komunikimin/sinjalizimin nga ana e punonjësve të subjektit, të mospërputhshmërisë me rregullat, procedurat, operacionet etj., duke siguruar njëkohësisht konfidencialitetin dhe mbrojtjen e këtyre të fundit (punonjësve).

5. Struktura/njësia e përputhshmërisë mund të kryejë dhe detyra të tjera të veçanta, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore të subjektit (të tilla si ato të parandalimit të pastrimit të parave etj.), si dhe mban lidhje me Bankën e Shqipërisë dhe/ose autoritete të tjera të mbikëqyrjes së veprimtarisë financiare, ekspertin kontabël të autorizuar etj.

6. Struktura/njësia e përputhshmërisë kryen detyrat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet rregullative të subjektit, mbështetur në një program pune, që përcakton aktivitetet e planifikuara, të tilla si zbatimi dhe rishikimi i politikave, procedurave të veçanta të rrezikut të përputhshmërisë, vlerësimet, testet e përputhshmërisë dhe edukimin e trajnimin e personelit për çështje të përputhshmërisë.

7. Programi i strukturës/njësisë së përputhshmërisë duhet të jetë i bazuar/fokusuar tek rreziku dhe duhet të rishikohet në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim që të sigurohet që ky program mbulon të gjitha linjat e biznesit/veprimtarisë së subjektit dhe siguron koordinimin midis funksioneve të administrimit të rrezikut.

NËNKREU II
EKSPOZIMI MAKSIMAL I LEJUESHËM

Neni 7
Kufizimet maksimale të lejueshme të ekspozimit të madh

1. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose një pale të tretë është shuma e të gjitha marrëdhënieve në aktiv të bilancit dhe të angazhimeve jashtë bilancit me këtë person ose kundërparti, dhe personave të lidhur me të.

2. Ekspozimi i subjektit, me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e qirasë financiare, ndaj një personi ose grupi personash të lidhur konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 10% (dhjetë për qind) e [11]kapitalit rregullator të subjektit.

3. Ekspozimi i subjektit ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, nuk mund të tejkalojë 15% (pesëmbëdhjetë për qind) të [12]kapitalit rregullator të subjektit, me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë [13]veprimtarinë e faktoringut dhe të qirasë financiare.

[11] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[12] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[13] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

4. Në ekspozimin e subjektit ndaj një personi nuk përfshihen:

   a) pretendimet që rrjedhin nga marrëdhëniet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, të siguruara me barrë siguruese mbi një depozitë monetare, deri në shumën e kësaj barre siguruese;
   b) tituj të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose të Bankës së Shqipërisë apo një garanci e patjetërsueshme e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë;
   c) [14]pjesëmarrjet në kapitalin e subjekteve të tjera, të cilat janë zbritur nga kapitali rregullator i subjektit.

5. Subjekti - me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë [15]veprimtarinë e faktoringut dhe të qirasë financiare - nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku tejkalojnë 600% të [16]kapitalit rregullator të subjektit.

Neni 8
Llogaritja e ekspozimeve të mëdha

1. [17]Subjektet, për qëllime të llogaritjes, raportimit dhe respektimit të kufizimeve maksimale të lejueshme të ekspozimeve të mëdha, ponderojnë me 20% (njëzet për qind) ekspozimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare që veprojnë në Republikën e Shqipërisë, që kanë një maturitet të mbetur më pak se 1 (një) vit.

2. Subjektet hartojnë procedura të brendshme dhe kontabël, si dhe mekanizma të kontrollit të brendshëm, për të identifikuar, regjistruar dhe monitoruar të gjitha ekspozimet e mëdha dhe ndryshimet e tyre.

Neni 9
Rreziku i likuiditetit

1. Rreziku i likuiditetit është mundësia e humbjes financiare si rezultat i mungesës së aktiveve likuide të mjaftueshme, për të përmbushur detyrimet kur ato maturohen dhe kërkohen, dhe/ose kur subjekti nuk ka mundësi të financojë rritjen e aktiveve të veta.

2. Subjektet krijojnë sistemin e administrimit të rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim miradministrimin e rrezikut të likuiditetit. Ky sistem përfshin minimalisht strategjinë dhe politikat për administrimin e rrezikut të likuiditetit, strukturën organizative të krijuar për administrimin e rrezikut të likuiditetit, sistemin e kontrollit të brendshëm, sistemin e administrimit të informacionit etj.

3. Subjektet sigurojnë që sistemi i administrimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e subjektit, tipologjinë e veprimtarisë së tij dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.

4. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

[14] Shtuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[15] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[16] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[17] Ndryshuar me vendimin nr.46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

a. raporti i aktiveve me maturitet të mbetur deri në një muaj ndaj detyrimeve me maturitet të mbetur njëmujor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);
b. raporti i aktiveve me maturitet të mbetur deri në tre muaj ndaj detyrimeve me maturitet të mbetur tremujor, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Neni 10
Normat e lejueshme për pozicionet e hapura valutore

1. Pozicioni i hapur valutor në një valutë të caktuar, përfaqëson shumën ekuivalente në lekë të diferencës midis të drejtave dhe detyrimeve gjithsej të subjektit, në këtë valutë.

2. Subjektet nuk duhet të tejkalojnë në fund të çdo dite pune, normat e mëposhtme për pozicionet e hapura në valutë:

   a) raporti i pozicionit të hapur valutor për një monedhë [18]me kapitalin rregullator, [19]nuk duhet të jetë më shumë se 30% (tridhjetë për qind); dhe
   b) raporti i pozicionit të hapur valutor për të gjitha monedhat [20] me kapitalin rregullator,[21]nuk duhet të jetë më shumë se 40% (dyzetë për qind)[22].

3. [23]Subjektet, në llogaritjen e pozicionit të hapur valutor nuk përfshijnë pozicionin strukturor në valutë, i cili është pozicioni që krijohet nga:

   a) elemente (zëra të bilancit ose jashtë bilancit), të cilat nuk janë të natyrës së veprimtarisë (biznesit) kryesore financiare të subjektit dhe/ose janë elemente të qëndrueshme/afatgjata të tilla si: “interesa pjesëmarrës”; investimet në “filiale”, “aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe të trupëzuara” etj.;
   b) transaksione të subjektit, të cilat ruajnë nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit, në rastet kur treguesi ndikohet nga luhatjet e kursit të këmbimit.

KREU III
ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E KREDIDHËNIES

NËNKREU I
EKSPOZIMI NDAJ RREZIKUT DHE KUFIZIMET

Neni 11
Treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit

1. Subjekti siguron nivele të mjaftueshme të kapitalit në funksion të një veprimtarie të sigurt dhe të qëndrueshme, si dhe të përmbushjes së detyrimeve të tij gjatë ushtrimit të kësaj veprimtarie.

[18] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[19] Ndryshuar me vendimin nr.46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[20] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[21] Ndryshuar me vendimin nr.46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[22] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[23] Shtuar me vendimin nr.46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

2. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e mjaftueshmërisë së kapitalit, siç përcaktohet në raportet e mëposhtëm:

   a. raporti i kapitalit rregullator[24] me totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më pak se 5% (pesë për qind) në vitin e parë të veprimtarisë, 8% (tetë për qind) në vitin e dytë dhe 10% (dhjetë për qind) në vazhdim;
   b. raporti i kapitalit rregullator [25] me totalin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);
   c. raporti i kapitalit rregullator[26] me totalin e kredive me probleme (neto), nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind).

Neni 12
Ekspozimi ndaj rrezikut dhe kufizimet

1. Subjekti, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përcakton kriteret dhe harton metodat e procedurat për identifikimin dhe monitorimin e të gjitha rreziqeve, në përputhje me aktet e brendshme të subjektit dhe aktet rregullative të Bankës së Shqipërisë.
2. Subjekti respekton në çdo kohë treguesit e ekspozimit ndaj rrezikut/qeve, siç përcaktohet në raportet e mëposhtme:

   a. raporti i aktiveve të qëndrueshme (neto) mbi totalin e aktiveve, nuk duhet të jetë më shumë se 20% (njëzet për qind) në vitin e parë të veprimtarisë dhe më shumë se 10% (dhjetë për qind) mbas vitit të parë të veprimtarisë;
   b. raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me detyrimet që shkaktojnë shpenzime, nuk duhet të jetë më pak se 100% (njëqind për qind);
   c. raporti i kredisë me totalin e aktiveve të subjektit, nuk duhet të jetë më shumë se 95% (nëntëdhjetë e pesë për qind);
   d. çdo investim në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 5% (pesë për qind) [27]të kapitalit rregullator të subjektit;
   e. totali i investimeve në tituj, me përjashtim të investimeve në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe titujve të emetuar nga qeveritë dhe/ose bankat qendrore të vendeve të OECD, nuk duhet të tejkalojë 40% (dyzetë për qind) [28]të kapitalit rregullator të subjektit.

3. [29]Subjektet, për qëllime të pikës 2 të këtij neni, konsiderojnë listën më të fundit të vendeve të OECD-së të publikuar nga kjo organizatë, në faqen e saj zyrtare të internetit.

[24] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[25] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[26] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[27] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[28] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[29] Shtuar me vendimin nr.46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

NËNKREU II
ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË

Neni 13
Rreziku i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka miratojnë dokumentet e strategjive, politikave, procedurave dhe rregullave të brendshme për monitorimin dhe kontrollin në vazhdimësi të cilësisë së portofolit të kredisë dhe të aktiveve të tjera.

2. Dokumentet e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, përmbajnë/përfshijnë minimalisht:

   a) strategjinë e kreditimit sipas periudhave, duke përfshirë objektiva realiste në lidhje me zgjerimin e portofolit të kredisë, përbërjen e tij sipas sektorëve, sipas gjeografisë, sipas monedhave, sipas llojit të kredisë etj.;
   b) politikat e normave të interesit, të afateve, të shlyerjeve dhe të madhësisë së kredive;
   c) rregullat e vendosur për njohjen dhe analizën e kredimarrësit dhe/ose të garantuesit të kredisë;
   d) procedurat për dokumentacionin e nevojshëm që duhet plotësuar për dhënien e kredive, si edhe për miratimin e kredisë, sipas hierarkisë;
   e) politikat e administrimit të rrezikut për të gjithë portofolin dhe për çdo klient në veçanti, kufijtë e kredisë për një klient, përqendrimin e kredisë sipas sektorëve, monitorimin sipas objektit dhe llojit të kredisë, analizën e mospërputhjeve të ndjeshme mes portofolit të kredisë dhe burimeve të financimit të tij përsa i takon afateve dhe llojit të monedhës, në drejtim të vlerësimit të lidhjes mes rrezikut të kredisë dhe rreziqeve të tjera (ndryshimi i kursit të këmbimit, ndryshimi i normës së interesit etj.);
   f) procedurat për ndjekjen në vazhdimësi të mbarëvajtjes së kredive dhe identifikimin e tyre sipas grupeve të kredive me karakteristika të njëjta, për ndjekjen me përparësi të kredive me probleme, për vlerësimin e mjaftueshmërisë së fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga kreditë, kriteret për ristrukturimin e kredive;
   g) procedurat për vlerësimin e cilësisë së aktiveve të tjera, për llogaritjen e fondeve rezervë për humbjet e mundshme nga zhvlerësimi i aktiveve, si dhe për vlerësimin e mjaftueshmërisë së tyre.

3. Subjektet financiare jobanka ruajnë në dosje të veçanta, të gjithë dokumentacionin përkatës për kredimarrësit.

Neni 14
Klasifikimi i kredisë

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e aktivitetit kredidhënës, bëjnë klasifikimin e kredisë të paktën një herë në tre muaj.

2. Subjektet financiare jobanka, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë dhe gjendjen financiare të kredimarrësit, i klasifikojnë kreditë, në një nga kategoritë e mëposhtme:

   a) “kredi standarde”, kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset e pritshme hyrëse të parasë, janë plotësisht të mjaftueshme për vazhdimësinë e veprimtarisë së tij dhe shlyerjen e detyrimeve,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht, për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

b) "kredi në ndjekje", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit dhe flukset hyrëse të parasë janë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht vështirësive financiare të momentit, dhe se nuk ka shenja përkeqësimi të gjendjes së kredimarrësit në të ardhmen,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht, për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

c) "kredi nënstandarde", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e rregullt të detyrimeve të prapambetura, ose subjekti nuk disponon gjithë informacionin e kërkuar ose të përditësuar, të nevojshëm për të vlerësuar plotësisht gjendjen financiare të tij,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

d) "kredi të dyshimta", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit, kapitali dhe flukset hyrëse të parasë vlerësohen si të pamjaftueshme për përmbushjen e plotë të detyrimeve - kredimarrësi shfaq probleme likuiditeti, dhe deklarimi i kredimarrësit "në paaftësi paguese/i falimentuar", vlerësohet si një mundësi reale,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit;

e) "kredi të humbura", kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

i. gjendja financiare e kredimarrësit vlerësohet qartë se nuk siguron përmbushjen e plotë të kushteve të shlyerjes së kryegjësë dhe të interesit; ose vlerësohet se mungon i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për përcaktimin e gjendjes financiare; ose kredimarrësi është në paaftësi paguese/ka falimentuar, është përfshirë në proces likuidimi; ose kredimarrësi ka vdekur dhe askush nuk mund të paguajë kredinë; ose subjekti ka vepruar juridikisht dhe në mënyrë përfundimtare (është marrë vendimi i formës së prerë të gjykatës) për të realizuar procesin e ekzekutimit të kolateralit,
ii. kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit.

3. Subjektet, në rastin kur kushtet e klasifikimit të kredive, të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni plotësohen për kategori të ndryshme të klasifikimit të kredisë, klasifikojnë kredinë në kategorinë më të ulët.

4. Subjektet, për persona ose grup personash të lidhur, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

Neni 15
Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, subjektet financiare jobanka krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

   a) për "kredinë standarde".....1% (një për qind);
   b) për "kredinë në ndjekje".....5% (pesë për qind);
   c) për "kredinë nënstandarde".....jo më pak se 20% (njëzet për qind);
   d) për "kredinë e dyshimtë" .....jo më pak se 50% (pesëdhjetë për qind);
   e) për "kredinë e humbur".....jo më pak se 100% (njëqind për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Subjekti financiar jobankë nuk kontabilizon interesat e përllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kredisë si kredi me probleme.

5. [30]Subjekti financiar jobankë, përjashtimisht nga sa parashikohet në këtë rregullore, për kreditë e lëvruara deri në shumën e kredive që përkufizohen si mikrokredi, klasifikon kreditë dhe krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve, sipas kritereve dhe normave të përcaktuara për institucionet financiare të mikrokredisë.

Neni 16
Ristrukturimi i kredisë

1. Subjektet, në marrëveshje me kredimarrësin, mund të ristrukturojnë kredinë sipas kritereve të përcaktuara në manualin e kredisë, të miratuar nga organet drejtuese. Ristrukturimi i kredisë mund të kryhet dhe kur, mbështetur në analizat e tyre, subjektet gjykojnë se në të ardhmen gjendja financiare e kredimarrësit do të përmirësohet ndjeshëm, ose të ardhurat nga veprimtaria e tij do të rriten në mënyrë të konsiderueshme dhe kredimarrësi do ta paguajë (shlyejë) të gjithë kredinë sipas kushteve të reja.

2. Kredia e ristrukturuar, nuk mund të klasifikohet më lart se një kategori nga kategoria në të cilën është klasifikuar përpara ristrukturimit dhe, në çdo rast, jo më lart se kategoria "nënstandard", deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

   a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt kështet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 9 (nëntë) muajsh nga data e ristrukturimit;

[30] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tre) këste (kryegjë dhe interes).

3. Kredia e ristrukturuar, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë kre.

Neni 17
[31]Fshirja e kredive nga bilanci

1. Fshirja e kredive nga bilanci[32] bëhet me vendim të organeve drejtuese të subjektit, si dhe në çdo rast kur Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe kërkuar fshirjen e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga organi drejtues i subjektit financiar jobankë. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira, konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

NËNKREU III
ADMINISTRIMI I RREZIKUT TË KREDISË
NË INSTITUCIONET FINANCIARE TË MIKROKREDISË

Neni 18
Klasifikimi i kredive për institucionet financiare të mikrokredisë

1. Institucionet financiare të mikrokredisë bëjnë klasifikimin e kredive, të paktën një herë në tre muaj.

2. [33]Institucionet financiare të mikrokredisë, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kredisë, i klasifikojnë ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

   a) "kredi standarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga afati i maturitetit;
   b) "kredi në ndjekje", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga afati i maturitetit;
   c) "kredi nënstandarde", kur kryegjëja ose interesi, nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga afati i maturitetit;
   d) "kredi të dyshimta", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga afati i maturitetit;
   e) "kredi të humbura", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga afati i maturitetit.

3. Çdo kredi e dhënë për të ripaguar një kredi tjetër së cilës i ka kaluar afati dhe kushtet e së cilës janë modifikuar pjesërisht, në rastin e zgjatjes së afatit të kredisë, ose tërësisht si në rastin e ristrukturimit të kredisë për shkak të kushteve të vështira financiare të kredimarrësit apo paaftësisë së tij për të paguar, nuk duhet të klasifikohet në një kategori më të lartë se ajo nënstandarde.

[31] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[32] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[33] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

4. Çdo kredi e dhënë në valutë të huaj klientëve të cilët nuk i kanë burimet e të ardhurave në valutë të huaj, nuk do të klasifikohet në një kategori më të lartë se kredia nënstandarde.

Neni 19
Llogaritja e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë

1. Në varësi të kategorive të klasifikimit të kredive, institucionet financiare të mikrokredisë krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga moskthimi i kredive.

2. [34]Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

   a) për "kredinë standarde".....1% (një për qind);
   b) për "kredinë në ndjekje"..... jo më pak se 15% (pesëmbëdhjetë për qind);
   c) për "kredinë nënstandarde"..... jo më pak se 30% (tridhjetë për qind);
   d) për "kredinë e dyshimtë" ..... jo më pak se 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind);
   e) për "kredinë e humbur"..... jo më pak se 100% (njëqind për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë, "për kategoritë "standarde" dhe "në ndjekje"[35], do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kredinë me probleme, norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.
4. Institucionet financiare të mikrokredisë, nuk kontabilizojnë interesat e përllogaritur duke filluar nga momenti i klasifikimit të kredisë si kredi me probleme.

Neni 20
Fshirja e kredive nga bilanci[36]

1. Institucioni financiar i mikrokredisë fshin kredinë nga bilanci kontabël, jo më vonë se tremujori i parë pasardhës, nëse ajo plotëson një nga kriteret e mëposhtme:

   a) kredia është klasifikuar si kredi me probleme dhe institucioni financiar i mikrokredisë konstaton se kredimarrësi nuk do të mund të paguajë detyrimin që lidhet me kredinë;
   b) kredimarrësi ka vdekur dhe nuk ka ndonjë trashëgimtar, garantues apo nënshkrues, i cili të mund të shlyejë detyrimin; ose
   c) [37]ka kaluar afati 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditor i ripagimit (shlyerjes) të kryegjësë apo interesit të kredisë;
   d) kredia është vlerësuar si e humbur nga inspektorët e mbikëqyrjes dhe në raportin e inspektimit është kërkuar fshirja e saj.

2. Dosjet e kredive të fshira ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në gjashtë muaj nga organet drejtuese të institucionit financiar të mikrokredisë. Çdo arkëtim nga këto kredi të fshira konsiderohet si e ardhur e jashtëzakonshme.

---

[34] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[35] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[36] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[37] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

[38]NËNKREU IV
TRAJTIMI I PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TË LUAJTSHME TË PËRFTUARA KUNDREJT SHLYERJES SË KREDIVE DHE BLERJA E KREDIVE ME PROBLEME

Neni 20/1
Kërkesa të përgjithshme

1. Subjektet hartojnë strategji dhe plane të brendshme, si dhe krijojnë strukturat e përshtatshme për shitjen e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna.

2. Subjektet, në rastet kur nuk mund të shesin pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara kundrejt shlyerjes së kredive brenda vitit të parë të përfitimit të tyre, krijojnë fonde rezervë për mbulimin e humbjeve.

Neni 20/2
Llogaritja e fondeve rezervë

1. Subjektet krijojnë fonde rezervë për pasuritë e paluajtshme brenda një periudhe jo më të gjatë se 10 (dhjetë) vite nga data e përftimit të tyre (marrjes së tyre në pronësi në përfundim të procesit të ekzekutimit të detyrueshëm për kreditë e pashlyera) dhe në nivelin jo më pak se norma në përqindje e vlerës kontabël të këtyre pasurive, sipas tabelës së mëposhtme:

Viti i parë	5%
Viti i dytë	10%
Viti i tretë	20%
Viti i katërt	30%
Viti i pestë	50%
Viti i gjashtë	60%
Viti i shtatë	70%
Viti i tetë	80%
Viti i nëntë	90%
Viti i dhjetë	100%

2. Subjektet krijojnë fonde rezervë për pasuritë e luajtshme në nivelin jo më pak se 100% të vlerës kontabël të pasurisë së luajtshme, në rastet kur nuk mund t'i shesin këto pasuri brenda një viti nga data e përftimit të tyre.

3. Subjektet, për pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme të përftuara deri në muajin dhjetor të vitit 2017, për efekt të llogaritjes së fondeve rezervë, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, do të konsiderojnë si vit të parë, vitin 2018.

Neni 20/3
Blerja e kredive me probleme

1. Subjektet financiare jobanka që blejnë kredi me probleme, brenda një periudhe 3-mujore nga data e blerjes, klasifikojnë kreditë bazuar në vlerësimin individual të tyre

[38] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

dhe në çdo rast, jo më lart se kategoria "nënstandard", deri në plotësimin njëkohësisht të kushteve të mëposhtme:

a) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt këstet (kryegjë dhe interes) për një periudhë prej 9 (nëntë) muajsh nga data e blerjes;
b) kredimarrësi ka shlyer në mënyrë të rregullt të paktën 3 (tre) këste (kryegjë dhe interes).

2. Kredia e blerë, me plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, klasifikohet duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë kre.

3. Subjektet llogarisin fondet rezervë për mbulimin e humbjeve nga kreditë e blera, bazuar në çmimin e blerjes së kredive me probleme.

KREU IV
ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E QIRASË FINANCIARE

Neni 21
Ekspozimi maksimal i lejueshëm

1. Ekspozimi i subjektit që ushtron veprimtarinë e qirasë financiare ndaj një personi ose grupi personash të lidhur, konsiderohet ekspozim i madh kur vlera e tij është e barabartë ose më e madhe se 25% (njëzet e pesë për qind) e [39]kapitalit rregullator të subjektit.

2. Subjekti nuk merr përsipër ekspozime të mëdha, të cilat të marra së bashku, tejkalojnë 1200% (njëmijë e dyqind) për qind të [40]kapitalit rregullator të subjektit.

Neni 22
Klasifikimi i kontratave të qirasë financiare

1. Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e qirasë financiare, bëjnë klasifikimin e kontratave të qirasë financiare të paktën një herë në tre muaj.

2. Subjektet financiare jobanka, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e kontratës së qirasë financiare, i klasifikojnë ato në një nga kategoritë e mëposhtme:

a) "standarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;
b) "ndjekje", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;
c) "nënstandarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës së këstit;

[39] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[40] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

d) “të dyshimta”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit;
e) “të humbura”, kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës së kështit.

3. [41] Subjektet financiare jobanka të licencuara për ushtrimin e qirasë financiare, zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje, për ekspozimet e ristrukturuara dhe ekspozimet që do të fshihen nga bilanci.

Neni 23
Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kontratat e qirasë financiare

1. Subjektet, në varësi të kategorive të klasifikimit, krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga mospagimi i kontratave të qirasë financiare.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

   a) për “kategorinë standarde”.....1% (një për qind);
   b) për “kategorinë në ndjekje”.....5% (pesë për qind);
   c) për “kategorinë nënstandarde.....jo më pak se 20% (njëzet për qind);
   d) për “kategorinë e dyshimtë”.....jo më pak se 20% (njëzet për qind);
   e) për “kategorinë e humbur”.....jo më pak se 20% (njëzet për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të paragrafit 2 të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kategoritë e përcaktuara në shkronjat “c”, “d” dhe “e” , norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Subjektet nuk kontabilizojnë interesat e përllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kontratës së qirasë në kategorinë nënstandarde.

KREU V
ADMINISTRIMI I RREZIKUT NË SUBJEKTET QË USHTROJNË VEPRIMTARINË E FAKTORINGUT

Neni 24
Të përgjithshme

1. Transaksionet faktoring nuk mund të kryhen kur faktori dhe palët e përfshira (qoftë edhe njëra apo nga të dy palët) janë persona ose grup personash të lidhur me njëri tjetrin.

2. Faktori nuk mund të kryejë transaksione faktoringu me dy (2) persona ose grup personash të lidhur mes tyre në marrëdhënien furnizues – blerës.

[41] Shtuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 25
Klasifikimi i kontratave faktoring

1. Subjektet bëjnë klasifikimin e kontratave faktoring të paktën një herë në tre muaj.

2. Subjektet i klasifikojnë kontratat faktoring, bazuar në ditëvonesat në shlyerjen e pagesës sipas datës (së pagesës) të përcaktuar në kushtet e kontratës faktoring, në një nga kategoritë e mëposhtme:

   a) "standarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 1 (një) deri 30 (tridhjetë) ditësh nga data e pagesës;
   b) "ndjekje", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 31 (tridhjetë e një) deri 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga data e pagesës;
   c) "nënstandarde", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 91 (nëntëdhjetë e një) deri 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditësh nga data e pagesës;
   d) "të dyshimta", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej 181 (njëqind e tetëdhjetë e një) deri 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës;
   e) "të humbura", kur kryegjëja ose interesi nuk është paguar plotësisht për një periudhë prej më shumë se 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditësh nga data e pagesës.

3. [42] Subjektet zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenet 16 dhe 17 të kësaj rregulloreje, për ekspozimet e ristrukturuara dhe ekspozimet që do të fshihen nga bilanci.

Neni 26
Normat e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga kontratat faktoring

1. Subjektet, në varësi të kategorive të klasifikimit, krijojnë fonde përkatëse rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kontratat faktoring.

2. Normat e llogaritjes së fondeve rezervë përcaktohen respektivisht si më poshtë:

   a) për "standarde".....1% (një për qind);
   b) për "në ndjekje".....5% (pesë për qind);
   c) për "nënstandarde".....jo më pak se 20% (njëzet për qind);
   d) për "e dyshimtë" .....jo më pak se 50% (pesëdhjetë për qind);
   e) për "e humbur".....jo më pak se 100% (njëqind për qind).

3. Norma për llogaritjen e fondit rezervë për mbulimin e humbjeve për dy kategoritë e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të paragrafit 2 të këtij neni, do të aplikohet njëlloj si për kryegjënë dhe interesin, ndërsa për kategoritë e përcaktuara në shkronjat "c", "d" dhe "e", norma e aplikuar mbi interesin e përllogaritur do të jetë 100% (njëqind për qind) për çdo kategori.

4. Subjektet nuk kontabilizojnë interesat e përllogaritur, duke filluar nga momenti i klasifikimit të kontratës së faktoringut në kategorinë nënstandarde.

[42] Shtuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KREU VI
[43]Shfuqizuar

Neni 27
[44]Shfuqizuar

Neni 28
[45]Shfuqizuar

Neni 29
[46]Shfuqizuar

KREU VII
KËRKESA RAPORTUESE[47]

Neni 30
Raportet financiare

1. Subjekti financiar jobankë mban llogaritë kontabël dhe përgatit raportet financiare për pasqyrimin e saktë dhe në përputhje me rregullat e metodat kontabël të gjendjes së tij financiare, mbi baza individuale ose të konsoliduara.

2. Llogaritë kontabël dhe raportet financiare përgatiten në formën dhe përmbajtjen e përcaktuar në ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 31
Auditimi ligjor[48]

1. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit[49] kontrollon dhe vlerëson përputhshmërinë e raporteve financiare të subjektit financiar jobankë, me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit[50] kontrollon dhe vlerëson:

   a) llogarinë e humbje-fitimit (pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve);
   b) bilancin kontabël;
   c) raportin për ndryshimet në kapital;

---

[43] Shfuqizuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[44] Shfuqizuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[45]Shfuqizuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[46] Shfuqizuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[47] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[48] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[49] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[50] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

d) pasqyrën e *cash – flow*;
e) zbatimin e politikave të fshirjes së zërave të bilancit;
f) raportet e konsoliduara;
g) [51]funksionin/njësinë e kontrollit të brendshëm;
h) regjistrimet kontabël;
i) sistemet e informacionit;
j) saktësinë dhe plotësimin e raporteve të paraqitura në Bankën e Shqipërisë;
k) mjaftueshmërinë e procedurave kontabël dhe zbatimin e rregulloreve;
l) shënimet që shoqërojnë raportet financiare.

Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit[52] verifikon saktësinë e mbajtjes të llogarive kontabël dhe të regjistrimeve financiare, përfshirë metodat e parashikuara nga Banka e Shqipërisë, si dhe përgatit një raport vjetor, lidhur me paraqitjen e plotë dhe të saktë të gjendjes financiare të subjektit financiar jobankë, duke u bazuar në raportet dhe deklaratat financiare të përgatitura nga subjekti, në përputhje me ligjin "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

3. [53] Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit emërohet çdo vit, nga mbledhja e përgjithshme e aksionarëve, për shoqëritë aksionare, ose nga asambleja e ortakëve, për shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar.

4. [54]Audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit, zëvendësohet për kryerjen e auditimit brenda një periudhe maksimale prej 7 vjetësh nga data e caktimit dhe mund të rimarrë pjesë në auditimin e subjektit pas mbarimit të një afati kohor prej, të paktën, dy vjetësh.

Neni 32
Raportimi në Bankën e Shqipërisë

1. Subjektet financiare jobanka raportojnë në Bankën e Shqipërisë sipas kërkesave të përcaktuara në "Sistemin raportues për subjektet jobanka që ushtrojnë veprimtari financiare", të miratuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Subjektet financiare jobanka dërgojnë në Bankën e Shqipërisë, brenda 6-mujorit të parë të vitit pasardhës, një kopje të raportit vjetor dhe të opinionit të ekspertit kontabël të autorizuar ku pasqyrohet gjendja financiare dhe kontabël mbi baza individuale dhe të konsoliduara.

3. Subjektet financiare jobanka detyrohen të raportojnë menjëherë në Bankën e Shqipërisë, për çdo rast të ekspozimit të madh dhe/ose të tejkalimit të normave mbikëqyrëse të lejueshme, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje. Banka e Shqipërisë përcakton dhe njofton subjektin financiar jobankë për kohën dhe masat e nevojshme, me qëllim rivendosjen e ekspozimeve brenda kufizimeve maksimale të lejueshme.

Neni 33[55]
Shfuqizuar

[51] Ndryshuar me vendimin nr.50, datë 3.7.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[52] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[53] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[54] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[55] Shfuqizuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

KREU VIII
[56]MASAT MBIKËQYRËSE DHE SANKSIONET

Neni 34[57]
Shfuqizuar

Neni 35[58]
Shkeljet për të cilat jepen masat

1. Banka e Shqipërisë vendos masat e parashikuara në nenet 36 dhe 37 të kësaj rregulloreje, në rast se subjekti:

   a) nuk respekton normat mbikëqyrëse për administrimin e rrezikut;
   b) kryen shkelje të dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi[59];
   c) ka shkelje të ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;
   d) nuk kryen raportimet në Regjistrin e Kredive;
   e) ka probleme serioze në sistemet dhe në programet e kontrollit të brendshëm, në politikat e veprimtarisë, në metodat e operacioneve ose në sistemet e informacionit të administrimit të saj, pavarësisht se këto probleme kanë ndikuar ose jo në gjendjen financiare të subjektit;
   f) nuk thirret asambleja e përgjithshme ose pengohet pjesëmarrja në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme;
   g) ka shkelje të akteve ligjore e nënligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
   h) ushtron veprimtari financiare të papërfshira në licencë;
   i) ekziston një mospërputhje me standardet e një veprimtarie të sigurt dhe të qëndrueshme, për një periudhë relativisht të gjatë;
   j) ka shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore, për shkak të të cilave [60]subjekti financiar jobankë ose institucioni financar i mikrokredisë ka pësuar një humbje të ndjeshme financiare ose ka filluar procesi i falimentimit;
   k) ka shkelje të ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe si rezultat nuk arrihet të përcaktohet gjendja financiare e subjektit;
   l) nuk është pranuar ose është refuzuar kërkesa e Bankës së Shqipërisë për ndërprerjen e veprimeve, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore, ose nuk janë marrë masat përkatëse për eliminimin e shkeljeve, sipas afateve të caktuara nga Banka e Shqipërisë;
   m) nuk jep informacion ose nuk jep informacion të vërtetë dhe të saktë gjatë inspektimeve të kryera nga Banka e Shqipërisë, si dhe në raportimet dhe korrespondencën me Bankën e Shqipërisë;
   n) ka fakte konkrete, lidhur me abuzime të brendshme, përfshirë edhe shpërblime të larta dhe të pajustifikuara për anëtarët e organeve drejtuese, pavarësisht faktit se subjekti, aktualisht, nuk rezulton i dëmtuar;
   o) ka shkelje të vullnetshme ose flagrante të akteve ligjore dhe nënligjore nga personeli dhe organet drejtuese ose përsëritje të tyre, të cilat kanë sjellë përfitime materiale apo favore;
   p) institucioni financiar i mikrokredisë nuk plotëson më kriteret për t'u karakterizuar si i tillë, për një periudhë prej jo më pak se 3 (tre) muajsh.

---

[56] Ndryshuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[57] Shfuqizuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[58] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[59] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[60] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 36[61]
Masa mbikëqyrëse

1. Banka e Shqipërisë, në përfundim ose gjatë inspektimeve, si dhe në çdo rast kur konstaton shkelje ose problematika të veçanta, të përcaktuara në nenin 35, pika 1 të kësaj rregulloreje, vendos masat mbikëqyrëse të mëposhtme:

   a) urdhëron ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës;
   b) urdhëron uljen e shpenzimeve;
   c) urdhëron kufizimin e rritjes së aktiveve dhe zërave jashtë bilancit me rrezik të lartë;
   d) urdhëron ndalimin e rritjes së ekspozimit ndaj një personi;
   e) urdhëron rritjen e kapitalit;
   f) cakton norma mbikëqyrëse më të larta se ato të përcaktuara në aktet nënligjore përkatëse;
   g) urdhëron administratorët ose ortakët të thërrasin mbledhjen e asamblesë së përgjithshme dhe t'i propozojnë marrjen e vendimeve përkatëse;
   h) ndalon ose kufizon përdorimin e lirë të një pjese apo të të gjitha aktiveve, duke përfshirë dhe veprimtarinë që lidhet me dhënien e huave dhe investimeve, sipas rregullave të miratuara nga Banka e Shqipërisë;
   i) kur raporti i kapitalit rregullator[62] me totalin e aktiveve është më i ulët se gjysma e raportit minimal të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë dhe pasi ajo ka marrë një ose disa nga masat e përcaktuara në këtë kre, ka të drejtë t'i kërkojë subjektit të rregullojë situatën brenda 6 muajve. Subjekti paraqet një plan veprimi, në të cilin përcakton mënyrën se si do të arrijë të rregullojë situatën. Në rast se subjekti nuk arrin të marrë masat e përcaktuara në planin e veprimit, Banka e Shqipërisë pezullon ose revokon licencën.

Neni 37[63]
Sanksionet

1. Banka e Shqipërisë, në përfundim ose gjatë inspektimeve, si dhe në çdo rast kur konstaton shkelje ose problematika të veçanta, të përcaktuara në nenin 35, pika 1 të kësaj rregulloreje, jep sanksionet e mëposhtme:

   a) urdhëron ndërprerjen e shpërblimit ndaj anëtarëve të organeve drejtuese dhe administratorit;
   b) [64] revokon miratimin e dhënë për administratorin/ët, kryetarin e këshillit të administrimit ose kryetarin e komitetit të kontrollit të subjektit;
   c) pezullon ushtrimin e një ose disa veprimtarive për një periudhë të caktuar;
   d) revokon licencën.

[61] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[62] Ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 21.12.2022 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[63] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[64] Ndryshuar me vendimin nr.50, datë 3.7.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Neni 38[65]
Kërkesa të veçanta në lidhje me masat mbikëqyrëse dhe sanksionet

1. Për vendosjen e masave të parashikuara në nenet 36 dhe 37, të kësaj rregulloreje, Banka e Shqipërisë vlerëson:

   a) rrethanat e kryerjes së shkeljeve;
   b) pasojat e shkeljeve;
   c) përsëritjen e shkeljeve.

2. Banka e Shqipërisë përshkallëzon masat ndëshkimore, në rastet kur subjekti nuk zbaton një ose më shumë nga masat e mësipërme.

3. Banka e Shqipërisë mund të marrë, njëkohësisht, masa, të cilat janë të përcaktuara në nenet 36 dhe 37, të kësaj rregulloreje, duke respektuar kërkesat e pikës 1 të këtij neni.

Neni 39[66]
Ankimi administrativ dhe gjyqësor

Banka e Shqipërisë, në rastet e masave mbikëqyrëse dhe sanksioneve të propozuara sipas neneve 36 dhe 37 të kësaj rregulloreje, i jep të drejtën e dëgjimit dhe ankimit administrativ dhe gjyqësor subjektit të interesuar, siç përcaktohet në nenin 92 dhe 93 të ligjit për bankat.

Neni 40[67]
Dispozitë e përkohshme

Pezullimin e zbatimit të kërkesave të Kreut III, neni 14 dhe neni 15 i kësaj rregulloreje, për periudhën mars deri maj 2020.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

ARDIAN FULLANI

[65] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[66] Shtuar me vendimin nr. 46, datë 6.9.2017 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
[67] Shtuar me vendimin qarkullues nr. 14, datë 12.3.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.